Republika e Kosoves

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves-(SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)

Hospital and university Clinical Service of Kosova-(HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosoves-universitetski Klinicki Centar Kosova

University Clinical Servise of Kosovo

RAPORTI I PUNËS

PËR VITIN 2021

Përgatitur nga :

Dr. Valbon Krasniqi

Drejtor i Përgjithshëm i ShSKUK-së

Mars 2022

Falënderim:

Pavarësisht angazhimeve dhe momenteve të vështira nëpër të cilat mund të kalojë, njeriu gjithmonë duhet të gjejë kohë për të ndaluar një moment për të falënderuar njerëzit që në çfarëdo forme dhe në çfarëdo niveli kontribuojnë në tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohet. Shëndeti individual dhe kolektiv i qytetarëve të Kosovës, këtyre 2 viteve të fundit u sfidua seriozisht duke u kërcënuar nga pandemia COVID-19. Ishin mantelbardhët, por jo vetëm, ata që u gjendën në ballë të përballimit të kësaj emergjence globale shëndetësore.

Duke pasur bindjen e thellë se mantelbardhët treguan profesionalizëm, përkushtim dhe vetmohim, por edhe sakrificë në përballimin e pandemisë COVID-19, zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-së, falënderon të gjithë mantelbardhët për punën e palodhshme që kanë treguar në përballimin e sfidave të shumta përgjatë vitit 2021, në mënyrë të veçantë në përballjen me sukses me pandeminë COVID-19. Falënderime të veçanta edhe për zyrtarët administrativ, punëtorët teknik, stafin mbështetës, donatorët dhe të gjithë ata që në një mënyrë apo tjetër ndihmuan në realizimin e objektivave tona.

Dhe së fundmi, i jemi mirënjohës qytetarëve që na besojnë çdo ditë që të kujdesemi për shëndetin e tyre dhe të familjarëve të tyre.

MISIONI

ShSKUK institucion dinamik i fokusuar në progres dhe përsosmëri në të gjitha fushat e veprimtarisë që të mund të ofrojë kujdes shëndetësor sa më cilësor për pacientët, në përputhje me trendet e mjekësisë moderne, i aftë për transformim dhe riorganizim të shpejtë duke iu përgjigjur nevojave dhe emergjencave shëndetësore lokale e globale.

VIZIONI

ShSKUK institucion shëndetësor i njohur për nga cilësia e shërbimeve të ofruara, me pacientin dhe familjen e tij në qendër të procesit të kujdesit shëndetësor, rezultat i një sistemi të organizuar i bazuar në vlera dhe parime si: barazia, gjithëpërfshirja, cilësia, ndershmëira dhe llogaridhënia, solidariteti dhe mosdiskrimini.

Përmbajtja

Falënderim ……..3
Misioni, Vizioni …….....4
Lista e Shkurtesave …….....6
Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-së……...7
Hyrje …….....9
Plani i Veprimit / Objektivat për vitin 2021.....10
Realizimi i Planit të Punës 12
OBJEKTIVA II: 12
OBJEKTIVA III: 19
OBJEKTIVA IV: 21
OBJEKTIVA V: 24
OBJEKTIVA VI: 26
OBJEKTIVA VII: 32
OBJEKTIVA VIII: 33
Struktura e të punësuarve në ShSKUK …….....34
Shërbimet e realizuara në ShSKUK ……36
Struktura e të punësuarve në QKUK …….....38
Performanca në QKUK …….....40
Burimet në njerëz në SP 47
Shërbimet e realizuara në SP ……51
Shërbimet e realizuara në QKSUK 54
Shërbimet e realizuara në QKMP Gjakovë.....55
Sëhrbimet e realizuara në QKTK 57
Shërbimet e realizuara në QKMS 58
Struktura e të punësaurve në QSHM 59
Shërbimet e ofruara në QSHM 60
Shërbime specofike në disa Klinika të QKUK-së.....61
Personeli i ShSKUK i infektuar me COVID-19 61
Donacionet e pranuara në ShSKUK gjatë vitit 2021 65

Lista e Shkurtesave

ShSKUK- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSh- Ministria e Shëndetësisë
BD- Bordi Drejtues
MF- Ministria e Financave
QKUK- Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK- Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP- Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë
QKMS- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTGJ- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
QKTK - Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës
SP- Spitali i Përgjithshëm
QSHMSHIB- Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSK- Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik
BQ- Barnatorja Qendrore

Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-së

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Univeristar të Kosovës, përkundër shumë sfidave përmbylli sukseshëm këtë periudhë të vitit me një punë voluminoze si në aspektin profesional shëndetësor dhe atë administrativ.

Prioritizimi i menaxhimit të pandemisë COVID-19 ka mundësuar një menaxhim të suksesshëm me pandeminë. Duke pasur tashmë një përvojë solide nga vitit i kaluar në menaxhimin e pandemisë COIVD-19, riorganizimin e personelit shëndetësorë dhe joshëndetësorë, riorganizimin e hapësirave spitalore për trajtimin e pacientëve me COVID-19, furnizimin shumë më të mirë me barëna dhe material shpenzues për nevojat e pacientëve me COVID-19, ShSKUK arriti me sukses të menaxhojë pandeminë COVID-19.

Krahas menaxhimit të pandemisë, sfidë e veçantë ishte ruajtja dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore për pacientët me sëmundje tjera jo-COVID.

ShSKUK arriti jo vetëm të menaxhojë pandeminë COVID-19 me sukses, por edhe ruajti dhe përforcoi shërbimet tjera shëndetësore. Edhe pse gjatë vitit 2021 Kosova u përball me valën më të ashpër të pandemisë COVID-19 gjatë muajit Gusht-Shtator, ShSKUK arritti që gjatë gjithë vitit (me përjashtim të një periudhe prej rreth 4 javë - gjatë muajit Shtator) të mbajë në funksion të gjitha shërbimet shëndetësore përfshirë vizitat ambulantore për pacientët jashtëspitalor si dhe operacionet kirurgjike elektive. Madje, krahas kësaj ShSKUK ka arritur që gjatë vitit 2021 të fillojë edhe me disa shërbime të reja shëndetësore për herë të parë, siç është psh. shërbimi i brachiterapisë, themelimi i shërbimit mikrobiologjik klinik, shërbimi i artimologjisë dhe studimit elektrofiziologjik të zemrës, fillimi i rekonstruimit plastik të gjirit, etj..

Pesë (5) suksese të veçanta do të konsideroja si të arritura kryesore gjatë vitit 2021:

- Menaxhimin me sukses të pandemisë COVID-19;
- Stabilizimin dhe furnizimin e qëndrueshëm me barëna dhe material shpenzues mjekësorë;
- Themelimin e Shërbimit Mikrobiologjik Klinik në QKUK dhe fillimin e disa shërbimeve të reja për herë të parë;
- Kursimin e miliona eurove si rezultat i vendosjes së rezervoarëve të oksigjenit të lëngshëm në Spitalet e Përgjithshme, por edhe kontraktimit të një sërë produktesh medicinale (barëna) më çmime më të lira se sa në vitet paraprake;
- Krijimin e mirëbesimit me donatorët duke siguruar mbështetje substanciale –donacione në barëna dhe paisje mjekësore në vlerë totale rreth 15 milion Euro (14,701,702 euro).

Kapitull i veçantë i punës së ShSKUK-së gjatë vitit 2021 është bashkëpunimi dhe koordinimi i afërt me Bordin Drejtues të ShSKUK-së, me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Financave dhe të Qeverisë së Kosovës, mbështetja dhe përkrahja e të cilëve ka bërë të mundur realzimin e objektivave të punës për vitin 2021. Kësaj duhet shtuar edhe bashkëpunimin me donatorët dhe mbështetjen e tyre të çmuar për ShSKUK.

Si sfida kryesore gjatë vitit 2021 do të veçoja:

- Pandeminë COVID-19
- Forcimin e kapaciteteve në njerëz si ato profesionale (shëndetësore) poashtu edhe shërbimet teknike dhe adminsitrative.

Angazhimi dhe bashkëpunimi ekipor - mjek, infermier, staf mbështetës, profesionistë administrativ dhe të shërbimeve teknike e përbën thelbin e organizatës sonë dhe më bën jashtëzakonisht krenar dhe mirënjohës që jam pjesë e saj dhe në krye të saj.

Në ShSKUK gjatë vitit 2021, janë ofruar gjithsejt 6.519.461 shërbime. Numri i pacientëve të spitalizaur gjithsej është 145,567 me 742,994 ditë shërimi në total.

- numri i lindjeve, në të gjitha njësitë e ShSKUK-së është 19,682 në total, prej të cilave 6,918 janë lindje të kryera me operacion; fëmijë të lindur janë 20,281;
- degët kirurgjike kanë realizuar gjithsejt 33,666 operacione kirurgjike;
- janë ofruar 3,789,875 shërbime laboratorike për 562,349 pacientë;
- janë realizuar 1,223,415 vizita ambulantore, dhe janë kryer 568,042 vizita tjera diagnostike;
- shërbime radiologjike të ofruara gajtë vititn 2021 gjithsej janë 370,501;
- shërbime tjera apo të veçanta janë kryer 405,586 shërbime;
- 117,431 është numri i seancave të hemodializës të realizuara në vititn 2021.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacient është 5.1 ditë, përderisa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në nivel të ShSKUK-së është 51%.

Në aspektin e menaxhimit të buxhetit dhe financave, ShSKUK ka arritur që të realizojë (shpenzojë) në masën prej 98% të buxhetit. Buxheti i përgjithshëm në dispzocion për ShSKUK gjatë vitit 2021 ishte 137,447,117.^{00} EURO. *(referuar tabelave finaciare te pjesa e raportit financiar).*

Realizimi i buxhetit për vititn 2021 në ShSKUK sipas kategorive kryesore ekonomike është si në vijim:

1. Paga dhe mëditje ---------- 100 %
2. Mallra dhe Shërbime ---------- 98.1 %
3. Shpenzime komunale ---------- 99.8 %
4. Investime kapitale ---------- 88.5 %

   Total ---------- 98.4 %

Hyrje:

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion unik, i formuar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Formimi i SHSKUK është saktësuar në nenin 62 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi. Në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se *"Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë"*. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë. Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:

1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);
1.2. Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
1.5. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;
1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;
1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjilan;
1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri;
1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;
1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.

Plani i Punës i ShSKUK-së për vitin 2021 përmban 8 objektiva me gjithsejt 50 aktivitete. Nga 50 aktivitetet e planifikuara, 43 prej tyre janë realizuar plotësisht dhe/ose pjesërisht, ndërsa 7 aktivitete nuk janë realizaur (kryesisht aktivitetet që kanë të bëjnë aktet nënligjore të njësive përbërëse të ShSKUK-së e që kërkojnë edhe mbështetje dhe përfshirje të institucioneve tjera. Shprehur në përqindje, 86% e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar plotësisht dhe /ose pjesërisht (43/50), ndërsa 14% (7/50) e aktiviteteve nuk janë realizuar.

Plani i Veprimit 2021: Objektivat dhe aktivitetet e realizuara vs. planifikuara gjatë vitit 2021
Tabela 1. Aanalia e objektivave/aktiviteteve të realizuara.

OBJEKTIVA		**AKTIVITETET**			
		Planifikuar	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Jo të realizuara
I.	Menaxhimi me pandeminë COVID-19	6	6	0	0
II.	Themelimi i shërbimeve të reja & përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore	10	5	3	2
III.	Menaxhimi efikas, rritja e trasnparen.& llogaridhënies	4	4	0	0
IV.	Furnizimi i rregullt me barëna dhe material shpenzues mjekësorë	4	4	0	0

V.	Furnizimi me pajisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt	3	3	0	0
VI.	Përmirësimi dhe zgjerimi i ambienteve spitalore– investimet kapitale	10	8	1	1
VII.	Reforma administrative	7	0	5	2
VIII.	Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve brendaspitalore	6	3	1	2
	Gjithsej	**50**	**33**	**10**	**7**

I. OBJEKTIVA I: **Menaxhimi me pandeminë COVID-19.**
Kjo objektivë përmban 6 aktivitete specifike, të cilat janë realizuar të gjitha. Këtij raporti i bashkangjitet një raport detal i veçantë lidhur me menaxhimin e pandemisë COVID-19.

II. OBJEKTIVA II: **Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore.**
Në këtë objektivë kanë qenë të planifikuara 10 aktivitetet specifike, nga të cilat 5 janë realizuar në tërësi dhe 3 pjesërisht; 2 aktivitete nuk janë realizuar;

III. OBJEKTIVA III: **Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies.**
Objektiva e tretë përmban 4 aktivitete, nga të cilat që të katërta janë realizuar.

IV. OBJEKTIVA IV: **Furnizimi i rregullt me barëna dhe material shpenzues.**
Furnizimi me barëna dhe material shpenzues në vitin 2021 është arritur të stabilizohet dhe është viti me furnizimin më të rregullt në nivel të ShSKUK-së. Të 4 aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj objektive janë realizuar plotësisht;

V. OBJEKITVA V: **Furnizimi me pajisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt.**
Edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar blerja e pajisjeve të reja mjekësore, qoftë me buxhetin vetanak, atë përmes huamarrjes nga MSh/Qeveria e Kosovës dhe përmes donatorëve. 3 aktivitetet e planifikuara të kësaj objektive janë realizuar me sukses;

VI. **OBJEKTIVA VI: Përmirësimi dhe zgjerimi i ambienteve spitalore– investimet kapitale.**
Investimet kapitale janë aktivitetet kryesore të organizatës; për vitin 2021 në nivel të ShSKUK janë planifikuar 10 aktivitete – projekte të mëdha të investimeve kapitale, nga të cilat 8 janë realizuar plotësisht, 1 pjesërisht dhe 1 në proces të realizimit;

VII. OBJEKTIVA VII: **Reforma administrative.**
Si një proces gjithmomë sfidues për të gjitha organizatat, edhe për ShSKUK procesi i reformës administrative rezultoi të jetë sfidues, qoftë për shkak të pandemisë COVID-19, qoftë për shkak të domosdoshëmrisë dhe kërkesave ligjore për përfshirjen në këtë proces të institucioneve tjera, në veçanti të MSh. Nga 7 aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj objektive, pesë (5) janë realizuar pjesërisht - kanë filluar të implementohen, ndërsa dy (2) aktivitete nuk janë realizuar.

VIII. OBJEKTIVA VIII: **Kontrolli dhe parandalimi i Infeksioneve brendaspitalore.** Ndonëse objektiva e fundit e planit të veprimit, për nga rëndësia paraqet një ndër objektivat me rëndësi të veçantë. Pandemia COVID-19 ka pasur sfiduar realizimin e kësaj objektive, sidoqoftë nga 6 aktivitetet e planifikuara 3 nga to janë realizuar, 1 është në proces dhe për 2 aktivitete nuk është arritur të fillojnë së realizuari.

REALIZIMI I PLANIT TË PUNËS - OBJEKTIVAVE / AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA

I. OBJEKTIVA I: Menaxhimi me pandeminë COVID-19.

Raporti i detajuar mbi menaxhimin e pandemisë COVID-19 është bashkangjitur si raport i veçantë.

II. OBJEKTIVA II: Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Gjatë vitit 2021 është arritur që të fillohet me disa shërbime të reja mjekësore për herë të parë, siç janë: themelimi i shërbimit të mikrobiologjisë klinike, shërbimet e brachiterapisë, korigjimi i aritmive me ablacion dhe studimi elektrofiziologjik i zemrës, rekonstruimi kirurgjik plastik i gjirit, dg.i kancerit të gjirit në fazat e hershme(in situ), etj.

- Themelimi i Shërbimit Klinik Mikrobiologjik në QKUK

Shërbimi Klinik Mikrobiologjik në QKUK u themelua me vendimin nr.protokoli 05-1872 të datës 19.03.2021 të Ministrit të Shëndetësisë duke pasuar vendimin e Bordit Drejtues të ShSKUK me nr.protokoli 291 dt.: 08.02.201 për miratimin e kërkesës për themelimin e Shërbimit Mikrobiologjik Klinik në kuadër të QKUK-së. Adaptimi dhe renovimi i hapësirave për Shërbimin Mikrobiologjik Klinik të QKUK-së ka filluar të bëhet që në vitin 2016 me mbështetjen direkte të Ambasadës Italiane në Kosovë. Poashtu edhe paisjet mjekësore laboratorike të nevojshme janë siguruar donacion nga Ambasada Italiane. Funksionalizimi i këtij shërbimi në fillim është mbështetur edhe me reagensa dhe material tjetër të nevojshëm nga Ambasada Italiane, ndërkohë që kishte mbështetje profesionale nga ana e Departeamentit Mikrobiologjik të IKSHPK-së. Ky departament ka ndihmuar edhe me reagensa gjatë vitit 2021 Shërbimin Mikrobiologjik Klinik deri sa gradualisht QKUK fillon të sigurojë materialin e nevojshëm mjekësorë dhe reagensat me burime vetanake. Kështu për vitin 2022 për nevojat e këtij shërbimi për reagensa dhe material tjetër të nevojshëm janë buxhetuar 250,000 euro. Sa i përket stafit mjekësorë, në fillim kishte të punësuar 6 profesionistë shëndetësorë (3 mikrobiolog dhe 3 teknik laborant të mikrbiologjisë), ndërsa gjatë vitit 2021 numri i stafit shëndetësorë u dyfishua, duke u forcuar kështu edhe me kapacietete në njerëz dhe tani numëron të punësuar gjithsejt 11 profesionistë shëndetësorë: 5 mikrobiolog dhe 6 teknik laborant të mikrobiologjisë.

Themelimi i Shërbimit
Mikrobiologjik Klinikë të QKUK-së

Funksionimi (puna) në Laboratorin
Mikrobiologjik Klinik të QKUK-së

Funksionimi (puna) në Laboratorin Mikrobiologjik Klinik të QKUK-së

Funksionimi (puna) në Laboratorin Mikrobiologjik Klinik të QKUK-së

- Mbindërtimi në Kardiologji i laboratorit për kateterizimin e zemrës në SP të Prizrenit

Projekti për mbindërtimin e sallës së kateterizimit në kardiologji në SP të Prizrenit ka vazhduar sipas planit dinamik të realizimit të punimeve. Përfundimi i punimeve ndërtimore për këto hapësira pritet të kryhet gjatë vitit 2022.

Punimet në ndërtimin e laboraorit të kateterizimit në SP në Prizren

- Fekondimi artificial (IVF) dhe laboratorit citogjenetik në Kl. Obstetrike-Ginekologjike

Punët ndërtimore për adaptimin dhe renovimin e hapësirave për shërbimin e fekondimit artificial dhe laboratorit citogjenetik kanë përfunduar në tërësi në vitin 2021. Mosfillimi i realizimit të shërbimeve të fekondimit artificial dhe laboratorik citogjenektik është si pasojë pamundësisë për të siguruar buxhet për blerjen e paisjeve mjekësore. Edhe përkundër përpjekeve që paisjet mjekësore të nevojshme të sigurohen eventualisht përmes donacioneve nga partnerët ndërkombetarë, kjo nuk është arritur të bëhet, e poashtu nuk u sigurua buxheti i mjaftueshëm për këto paisje as me Ligjin e Buxhetit për vitin 2021 dhe atë 2022. Kosto e përafërt për këto pajisje e llogaritur nga Klinika e Gjinekologjisë dhe Sektori i Pajisjeve Mjekësore është rreth 1.2 milion euro. ShSKUK do të kërkojë sërish nga Qeveria e RKS që me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2022 të sigurojë mjetet e nevojshme financiare për këto paisje mjekësore.

- Funksionalizimi i Brachiterapisë në Klinikën e Onkologjisë

Edhe pse aparatura e brachiterapisë ishte siguruar rreth 2-3 vite më herët, shërbimet për pacientë nuk kishin filluar. Vetëm pas angazhimit direkt të menaxhmentit të ri të ShSKUK-së, pas përgatitjeve dhe trajnimeve/asistenceës së siguruar nga kolegët profesionist nga Shkupi, shërbimi i brachiterapisë arrin të funskionalizohet në fillim të muajit Mars 2021 dhe nga ajo kohë është arritur të ofrohen shërbime për 103 paciente, me gjithsejt rreth 450 seanca raditerapeutike të realizuara. Fillimi i shërbimeve të brachiterapisë në Kosovë, përveq shërbimeve cilësore që ofrohen për pacientet kosovarë, ka edhe kursim të konsiderueshëm financiar për buxhetin e Kosovës, pasi deri më tani për këto shërbime pacientet janë dërguar jashtë Kosovës dhe një seancë ka kushtuar mesatarisht rreth 1,100 euro; kështu nëse llogarisim numrin e përgjithshëm të seancave brachi-radioterapeutike të realizuara gjtë vitit 2021, rezulton se janë kursyer rreth gjysëm milioni euro (450 seanca x 1,100 Euro) vetëm shpenzime direkte për brachiterapi.



Funksionalizimi i Brachiterapisë në Klinikën e Onkologjisë

- Funksionalizimi i Qendrës për trajtimin e Infarktit Akut të Trurit

Aparati i ri angjiografisë i diagnostikës së neuroradiologjisë me radiologji intervente në hapësirën e Klinikës së Neurologjisë është montuar; pas kompletimit të mbrojtjes nga rrezatimi është liçencuar dhe ka filluar të përdoret. Gjatë vitit 2021 janë kryer 33 shërbime me metodën DSA (Digital subtraction angiography). Gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2022 planifikohet të sigurohet edhe medikamenti alteplase për të filluar me shërbimet e trombolizës tek infakrti akut i trurit. (gjatë vitit 2021 disa herë ka dështuar lidhja e kontratës për blerjen e medikamentit alteplase për shkak të mungesës së ofertave)

- Themelimi i Njësisë së Aritmologjisë në Klinikën e Kardiologjisë

Studimi Elektrofiziologjik i Zemrës dhe korigjimi i aritmive përmes ablacionit është një nga shërbimet e reja të planifikuara për vitin 2021, Pas shumë përpjekjeve dhe angazhimeve, është arritur që në fund të vitit 2021 të fillohet me ofrimin e këtyre shërbimeve për herë të parë në QKUK / Klinikën e Kardiologjisë, Kjo është bërë e mundur pas trajnimeve disa mujore të 2 kardiologëve të QKUK-së në Bullgari dhe sigurimit të materilit shpenzues mjekësorë. Gjatë Dhjetorit 2021 janë trajtuar 5 pacientë me këtë metodë nga kardiologët kosovarë të trajnuar, por në mbikqyrjen e ekspertëve nga Bullgaria. Trajnimi dhe avansimi profesional i kardiologëve do të vaszhdojë edhe gjatë vitit të ardhshëm, ndërkohë që është buxhetuar/siguruar buxheti i nevojshëm për materialin shpenzues mjekësorë për këto shërbime.



Fillimi i punës për trajtimin e aritmiv përmes ablacionit – shërbimi i aritmologjisë dhe studimit elektrofiziologjik të zemrës

- Trajtimi stomatologjik i pacientëve me anestezion të përgjithshëm & Entonox

Aktivitetet e kryera për fillimin e përdorimit të kësaj metode të re gjatë vititi 2021 janë si më poshtë:

- është bërë kërkesa në Odën e Stomatologvëe për arësyeshmërinë profesionale të përdorimti të kësaj metode; Oda e Stomatolgovë ka miratuar aplikimin e kësaj metode, e cila është përcjellur në MSh për miratim si shërbim i ri që duhet filluar.
- janë trajanuar katër (4) profesionist stomatologë për përdorimin e kësaj metode gjatë Tetorit 2021;
- zyra e prokurimit e QKSUK ka filluar procedurat për blerjen e pajisjes përkatëse për sedacion inhalator, por nuk është arritur të lidhet kontratë ende, pasi nuk ka pasë aplikues nga asnjë kompani (OE).

- Zvogëlimi i listave të pritjes për shërbime të caktuara shëndetësore

Pandemia COVID-19 ka pasë ndikim negavit direkt për sa i përket adresimit të listave të pritjes. Gjatë vitit 2021 Kosova ka përjetuar 2 valë epidemike; në Mars-Prill 2021 dhe gjatë muajve Gusht-Shtator 2021. Vala e fundit Gusht-Shtator 2021 ishte vala më e ashpër me të cilën u ballafaqua Kosova që nga fillimi i pandemisë. Kështu, me nevojën e ri-organizimit të stafit shëndetësorë dhe atij mbështetës në funksion të sigurimit të shërbimeve të nevojshme për pacientët me COVID-19, e sidomos në mungesë të anesteziologëve (numri i anesteziologëve në ShSKUK është nën limitin e çdo standardi, ndërsa angazhimi i tyre direkt në trajtimin e pacientëve me format më të rënda klinike – atyre në kujdesin intenziv me COVID-19 ka bërë që blloqet operative të mos kenë mundësi të punojnë më kapacitete të plota) ka ndikuar në pamundësinë e adresimit të listave të pritjes.

Edhe përkundër kësaj, në disa klinika të QKUK-së janë shënuar përmirësime në këtë drejtim, si psh në Klinikën e Syve ku listat e pritjes dhe kohëzgjatja e pritjes është zvogëluar p.sh. për korigjimin e strabizimit dhe ptozat 1-3 muaj, ndërsa për oeprimin e tumorëve 1-2 javë; poashtu edhe numri i pacientëve për referim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (JISHP) në këtë klinikë është zvogëluar ndjeshëm, nga rreth 500 pacientë sa ishin referuar në vitin 2019 për TJISHP, ky numër në vitin 2021 ka rënë në më pak se 100 pacientë; ose shprehur në vlera financiare, nga rreth 2 milion euro sa ishte në vitin 2019, ka rënë në më pak se gjysëm milioni euro në vitin 2021. Numër përafërisht i njjëtë i pacientëve - rreth 500, dhe vlerë e njëjtë financiare - rreth 2 milion Euro, ishte referuar nga kjo klinikë edhe gjatë vititn 2018. Edhe në disa klinika tjera kanë filluar sinjale pozitive në këtë drejtim, ndërsa që situatë më e rënduar me listat e pritjes paraqitet në Klinikën e Ortopedisë dhe atë të Kirurgjisë Vaskulare.

- Vendosja e instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit të punës së personelit shëndetësorë

Gjatë vititi 2021 shumicës së drejtorëve të njësive përbërese të ShSKUK iu ka skaduar kontrata, andaj në shumicën e tyre është bërë zgjedhja e drejtorëve të ri. Vet procesi i konkurseve – përzgjedhja e drejtorëve ka konsumuar kohë të konsiderueshme, gjë që ka ndikuar në kufizimin e realizimit të këtij aktiviteti. Procedurat e konkursit – përzgjedhja e drejtorëve nga njëra anë, angazhimi i personelit të administratës në procedurat e konkursit nga ana tjetër dhe pandemia COVID-19, ka limituar kapacitetet një njerëz për realizimin e aktivitetit të mësipërm.

- Zhvillimi i instrumenteve (mekanizmave) për matjen e kënaqshmërisë së pacientëve me shërbimet e ofruara nga ana e institucioneve shëndetësore

Pandemia COVID-19 ka pasë ndikimin më të madh edhe për sa i përket mosrealizimit të këtij aktiviteti. Në bashkëpunim me Shoqatën për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve jemi dakorduar që ky aktivitet të fillojë së implementuari gjatë vitit 2022.

III. OBJEKTIVA III: Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies

Objektiva e III-të e planit të punës përmban 4 aktivitete, dhe që të katërta janë realizuar.

- Hartimi i një plani me përcaktim të standardeve adekuate të punës, me arsyeshmëri për kuadrin e nevojshëm sipas lëmive /degëve.

Lidhur me realizimin e këtij aktiviteti, Drejtori i Përgjishshëm i ShSKUK-së ka formuar komision përkatës profesional me vendimin nr.465 të datës 19.01.2021. Komisioni ka analizuar faktorët dhe indikatorët e ndryshëm që kanë ndikim në përcaktimin e kuadrit optimal për ofrimin e shërbimeve shëndetësore sipas degëve/lëmive të caktuara. Për shkak të ballafaqimit me pandeminë COVID-19 Komisoni ka marë parasysh edhe nevojat e shtuara për rastet e tilla të ngjajshme dhe i ka reflektuar këto nevoja në analizën /tabelën përfundimtare, e cila është e bashkangjitur në këtë raport. (tabela nr.2).

- Decentralizim dhe autonomi menaxheriale të SP dhe Klinikave të QKUK-së

Të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK-së gjatë vitit 2021 kanë udhëhequr dhe menaxhuar në mënyrë autonome si me burimet në njerëz ashtu edhe me buxhetet e tyre të miratuara. Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së për këtë qëllim ka mbajtë disa takime me drejtorët e njësive përbërëse të ShSKUK-së me ç'rast ka transmetuar mesazhin për menaxhim autonom të njësive nga ana e tyre, por edhe me përgjegjësitë dhe logaridhënien. Kështu, vlen të përmenden takimet e realizuara me Drejtorët e SP bashkë me ZKF e SP për nevojën e ngritjes së cilësisë në planifikim, kontrollë dhe realizim të buxhetit, pastaj takimin e përbashkët me Drejtorët e SP bashkë me farmacistat përgjegjës të SP për nevojën e planifikimt të drejtë dhe me kohë për barna dhe material shpenzues mjekësorë; decentralizimi i tërësishëm i procedurave të rekrutimit të stafit profesional dhe atij mbështetës nga ana e njësive përbërëse të ShSKUK në mënyrë plotësisht të pavarur, dhe procese e aktivitete tjera të udhëhequra dhe menaxhuara nga vet njësitë përbërëse të ShSKUK-së konform legjislacionit në fuqi.

- Fuqizimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik i ShSKUK-së me qytetarët dhe Shoqatën për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve.

Gjatë vitit 2021 është zhvilluar një komunikimi efektiv dhe i vazhdueshëm me qytetarët në forma të ndryshme, sidomos lidhur me pandeminë COVID-19, por jo vetëm;

- Publikimi i regullt i raporteve ditore në ëebfaqen e ShSKUK-së dhe portalet online lidhur me numrin e pacientëve me COVID-19 që marrin trajtim çdo ditë në QKUK dhe SP ka qenë një ndër aktivitetet komunikuese më cilësore;
- Publikimi i shërbimeve të veçanta, në raste të veçanta poashtu është treguar i mirëpritur nga ana e qytetarëve;

- Paraqitjet publike, sidomos të Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-së, qoftë në formë intervistave nga QKUK, qoftë me pjesëmarrje fizike në studiot e mediave telvizive kanë qenë pothuajse të rregullta, të paktën në baza javore. Shtuar kësaj edhe paraqitjet publike / intervistat e drejtorëve të klinikave të QKUK dhe atyre të SP, por edhe të profesionistëve tjerë shëndetësorë, ka bërë që pothuajse në baza ditore të ketë komunikim me qytetarët;
- Përgjigjet në formë zyrtare për të gjitha kërkesat, shqetësimet apo edhe ankesat e qytetarëve dhe pacienëtve që i janë drejtuar ShSKUK-së, përbën një formë tjetër të komunikimit me qytetaarët dhe pacientët;
- Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Bordit Dejtues të ShSKUK-së e përfaqësuesit të Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve avanson dhe thellon bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe komunikimin me pacientët.
- ShSKUK vazhdon të ofrojë mbështetje me ambiente pune/zyre pune për Shoqatën për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve;
- Përmes përfaqësuesit të tyre, Shoqata për Mbrojtejn e të Drejtave të Pacientëve është përfshirë drejtëpërdrejtë në planifikimin e aktiviteteve (planit të verpimit) për vitin 2022 për ShSKUK, dhe do të jetë partner aktiv në adresimin e listave të pritjes së pacientëve për marrjen e shërbimeve shëndetësore;

➢ Përmirësimi i cilësisë së raporteve periodike & vjetore nga njësitë përbërëse të ShSKUK

Përzgjedhja e drejtorëve të ri në njësitë përbërëse të ShSKUK-së ka ndikuar që edhe këtë vit për raportimet vjetore të përdoren modelet (templatet) aktuale. Megjithatë përgjatë vitit 2021 nga njësitë përbërëse të ShSKUK-së janë kërkuar dhe hartuar edhe raporte tjera, me tema specifike siq janë psh.:

- raportet lidhur me furnizimet dhe shpenzimet për barëna dhe material mjekësor;
- raportet për listat e pritjes së pacientëve;
- format e reja të raportimit lidhur me furnizimet/shpenzimet për barëna të grupeve specifike;
- një avansim i raportimit është realizuar edhe me institucionet tjera, sidomos me Ministrinë e Financave, Tranfereve dhe Punës lidhur me shpenzimet e mjeteve financiare nga ana e ShSKUK-së pas rishikimit të buxhetit dhe për dy mbështetjet shtesë financiare të ShSKUK-së për furnizim me barëna dhe material mjekësorë;
- përmirësimi i cilësisë së raporteve është vënë re dhe është potencuar edhe nga ana e Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve.

IV. OBJEKTIVA IV: Furnizimi i rregullt me barëna dhe material medicinal shpenzues

Viti 2021 shënon vitin me furnizimin më të qëndrueshëm dhe stabil me barëna dhe material shpenzues mjekësorë që prej vitesh. Përveq sigurimit të shumicës së barënave për trajtimin e pacientëve me COVID-19, ShSKUK ka arritur që gjatë vitit 2021 të sigurojë një furnizim stabil me barëna dhe material shpenzues mjekësorë bazuar në kërkesat e njësive përbërëse të ShSKUK-së.

Tre (3) janë faktorët / veprimet kryesore që kanë ndikuar në përmirësimin e furnizimit me barëna dhe material shpenzues mjekësorë:

1. Mbështetja e Ministrisë së Financave / Qeverisë së Kosovës me rastin e rishikimit të buxhetit me 8 milion euro për barëna për nevojat e ShSKUK-së; krahas kësaj edhe mbështetja me financa shtesë në fund vit – fillimisht me 3.2 milion euro e pastaj edhe me 2.5 milion euro për furnizim me barëna dhe material shpenzues mjekësorë, në veçanti për citostatikë (barëna kundër sëmundjeve kanceroze);
2. Përkrahja e donatorëve me barëna dhe material shpenzues mjekësorë, sidomos për nevojat e pacientëve me COVID-19 si dhe me pajisje mbrojtëse për personelin shëndetësorë;
3. Forcimi i mekanizmave mbikqyrës dhe të monitorimit lidhur me shpenzimin e barënave dhe materialit shpenuzes mjekësorë në nivel të ShSKUK-së;

Aktivitet kryesore në kuadër të kësaj objektive të realizuara gjatë vitit 2021, janë:

- Hartimi i planit për furnizim me barna dhe material shpenzues me kohë dhe cilësor.

Planifikimi i drejtë dhe cilësor i barënave dhe materialit shpenzues mjekësorë është hapi i parë dhe faza më e rëndësishme për të siguruar furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm me barëna dhe material shpenzues mjekësorë gjatë gjithë vitit. Në këtë drejtim, planifikimi për vitin 2021 ka qenë një planifikim më i strukturuar, më gjithpërfshirës, i mbikqyrur dhe bazuar në mundësitë buxhetore të lejuara dhe kapacitetet në njerëz. Sfida kryesore në planifikim për vitin 2021 padyshim është pandemia COVID-19.

Në kuadër të përmirësimit të planifikimit, verpimet e ndërmarra janë si më poshtë:

- është siguruar gjithëpërfshirje më e gjerë në planifikim, duke filluar nga përgjegjësit e barnatoreve të njësive të ShSKUK-së deri te menaxherët më të lartë të institucioneve;
- është siguruar një mbikqyrje më rigoroze nga shërbimi klinik farmaceutik i QKUK-së, duke siguruar feed-bak në kohën optimale për njësitë përbërëse të ShSKUK-së;
- janë organizuar takime të përbashkëta me drejtorët dhe përgjegjësit e barnatoreve të njësive përbërëse të ShSKUK për të vënë në pah rëndësinë e planifikimit dhe marrjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për planifikim;
- si gjithnjë, mundësitë buxhetore zakonisht janë dukshëm më të vogla krahasuar me nevojat për barëna dhe material shpenzues mjekësorë.

- Shpërndarja e produkteve medicinale në kohë sipas kërkesave të njësive respektive

Në bazë të raportit të Shërbimit Klinik Farmaceutik të QKUK-së gjatë vitit 2021 është arritur që kërkesat e njësive përbërëse të ShSKUK-së të plotësohen nga 80% - 90%. Edhe pse kjo përqindje nuk pasqyron nevojat reale të pacientëve për barnëa, pasi nevojat janë shumë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore, megjithatë kjo reflekton furnizimin e rregullt bazuar në kërkesat e njësive përbërëse të ShSKUK-së përgjatë vitit 2021. Vëmendje e caktuar është vënë në furnizimin në kohë optimale sipas kërkesave, e në raste të caktuara shkëmbimin-bashkëpunimin mes njësive përbërëse të ShSKUK-së në momente të mungesave të përkohshme për barëna të caktuara, sidomos me barënat për trajtimin e pacientëve me COVID-19.

Menaxhimi efektiv i kontratave për furnizim me barëna dhe material shpenzues mjekësorë, si dhe inicimi me kohë i procedurave të prokurimit për blerjen e barënave dhe materialit shpenzues mjekësorë, kanë qenë aktivitete të rëndësishme me ndikim direkt në furnizimin e qëndrueshëm dhe stabil me barëna dhe material shpenzues mjekësorë.

- Bashkëpunim i ngushtë me donatorët për furnizim me barna dhe material shpenzues

Komunikimi i vazhdueshëm me donatorë, paraqitja e nevojave dhe arësyeshmëria objektive e profesionale për nevojat e prezantuara tek donatorët kanë qenë fokusi kryesor i kërtij aktiviteti. ShSKUK ka arritur që të ndërtojë raporte të mirëbesimit të ndërsjellë me donatorët ndërkombëtarë në veçanti dhe bashkëpunimi është thelluar në vazhdimësi. Vlen të potencohet fakti se donatorët kanë qenë mjaft aktiv dhe përkrahës të fuqishëm të ShSKUK-së. Sidomos me paraqitjen e pandemisë COVID-19 përkrhaja dhe bashkëpunimi kanë evoluar drejt vendosjes së një bashkëpunimi të rregullt dhe konsistent. Krahas mbështetjes me paisje mjekësore, bashkëpunimeve në fushën e trajnimeve, shkëmbimit të eksperiencave të ndërsjella, vizitave studimore, përkrahjes në fushën e infrastrukturës së objekteve spitalore, e të tjera, ShSKUK gjatë vitit 2021 ka përfituar donacione të barënave dhe materialit shpenzues mjekësorë në vlerë totale prej më shumë se 11 milion Euro (11,272,666 Euro). ShSKUK falënderon të gjithë donatorët që i qëndruan afër pacientëve gjatë kësaj kohe të vështirë të emergjencës shëndetësore me pandeminë COVID-19.

- Rritja e menaxhimit dhe kontrollit të shpenzimit të barënave dhe materialit shpenzues

E arritura më e madhe gjatë vitit 2021 në kontrollin e shpenzimeve të barënave dhe materialit shpenzues mjekësorë është funksionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF) në disa klinika të QKUK-së. Ky sistem përbën ***një pikë kthese në rritjen e kontrollit dhe menaxhimit të barënave në sistemin shëndetësorë dhe do të jetë viti i kthesës në menaxhimin efikas dhe rritjen e kontrollit e llogaridhënies*** në shpenzimin e barënave dhe materialit shpenzues mjekësorë.

SMSF – është sistem përmes së cilit Barnatorja Qendrore, Barnatoret e Klinikave dhe Barnatoret e Reparteve mund të regjistrojnë planifikimin, buxhetin, kërkesat, porositë, stokun dhe shërbime tjera përfshirë këtu edhe daljet për pacientë.

Kështu, gjatë vitit 2021 në kuadër të **Barnatoreve të Klinikave** të cilat furnizohen drejtëpërdrejtë nga **Barnatorja Qendrore e QKUK-së**, janë funksionalizuar edhe **Barnatoret e Reparteve,** apo ndryshe të quajtura **Barnatore Doracake**, të cilat furnizohen nga Barnatoret e Klinikave dhe më pas shkarkohen përmes modulit për dalje për pacientë apo përmes daljes për stafin shëndetësorë. Pra, ky sistem mundëson që ilaqet të monitorohen në mënyrë elektronike që nga momnenti i daljes nga Barnatorja Qendrore e deri tek pacienti që i jepet; thjeshtë jep informata të sakta për llojin e ilaqit që i është dhënë pacientit, nga kush i është dhënë dhe kohën reale të dhënjes së ilaqit, duke siguruar në këtë mënyrë informatat e nevojshme për secilin ilaq se ku është shpenzuar.

Përmes këtij sistemi gjatë vitit 2021 në QKUK janë regjistruar rreth 10,000 produkte /barëna - dalje të realizuara për barnatoret doracake që kanë fillaur të përdorin SMSF. Ndërkohë që janë realizuar trajnime për këtë sistem (SMSF) në tri Spitale të Përgjithshme: Vushtri, Ferizaj dhe Pejë.

Përveq kontrollit të shpenzimeve të barënave ky sistem mundëson edhe planifikime më të sakta për vitet pasuese.

SMSF me modulet për **barnatoret e reparteve** aktualisht ofron këto mundësi:

- ✓ Modulin për menaxhimin e kërkesave kundrejt barnatoreve klinike: të bëjnë kërkesa të reja, të pranojnë kërkesa, të shohin listën e kërkesave të bëra;
- ✓ Modulin për transferet brenda reparteve;
- ✓ Modulin për produktet (barënat) e skaduara/dëmtuara;
- ✓ Modulin për Daljet (daljet e Barnatoreve të Klinikave për Barnatoret e Reparteve, pranimin e daljeve);
- ✓ Modulin për kartela rë produkteve;
- ✓ Modulin për raportet, i cili ofron mundësi të shumëta, si: raportet e hyrjeve, të daljeve, raprotet e stokut (raproti i stokut aktual, stoku aktual në sasi, pa çmime, stoku për periudha të caktuara kohore, gjendja e stokut sipas produkteve, qëndrueshmëria e stokut, stoku i rezervuar, ndarja e artikujve sipas llojit), raportet mbi produktet dhe raportet mbi daljet për pacient, raportet mbi kërkesat dhe raportet statistikat.

Krahas, SMSF të janë ndërmarrë edhe veprimet e mëposhtme:

- është monitoruar stoku farmaceutik në baza të rregullta mujore;
- është monitoruar për së afërmi shpenzimi i barënave nga njësitë përpbërëse të ShSKUK-së veç e veç krahasuar me planifikimet e tyre vetanake;
- janë bërë analiza të rregullta 3-mujore, me theks të posaçëm për grupet e barënave me kosto të lartë financiare, siç janë citostatikët, barënat që përdoren për pacientët në hemodializë, barënat imunologjike, etj.,për të monitoruar dinamikën e shpenzimeve të tyre dhe për të reaguar me kohë sipas nevojës.

V.	**OBJEKITVA V: Furnizimi me paisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt.**

Edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar blerja e paisjeve të reja mjekësore, qoftë me buxhetin vetanak, atë përmes huamarrjes nga MSh/Qeveria e Kosovës dhe përmes donatorëve. Një pjesë e konsiderueshme e paisjeve mjekësore të siguruara gjatë vitit 2021 janë destinuar për përmirësimin e cilësisë së trajtimit të pacientëve me COVID-19. Me buxhet vetanak të ShSKUK-së janë realizaur blerje në paisje mjekësore në vlerë rreth Euro, ndërsa përmes donacioneve janë siguruar paisje mjekësore në vlerë prej më shumë se 3 milion Euro (3,242,095 Euro).



Paisje mjekësore (Solar Blue MMS me paisje përcjellëse) për Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijë, donator Rotary Club Prishtina NeëBorn (vlera financiare mbi 50 mijë euro)

Krahas pasisjeve mjekësore të destinuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë për trajtimin e pacientëve me COVID-19, janë siguruar pajisje mjekësore nga më të ndryshmet, si: CT aparate për Spitalin e Ferizajt, Gjakovës dhe Prizrenit, X-ray digjital për të gjitha Spitalet e Përgjithshme dhe disa klinika të QKUK, Mamograf digjital për Spitalin e Mitrovicës, Gjilanit, Ferizajt dhe Prizrenit, Rtg aparate, ECHO aparate, analizator biokimik, hematologjik, gazore, etj, aparate të gastroskopisë, kolonoskopisë dhe aparatura tjera endoskopike, autoambulanca, respiratorë, monitorë, shtretër e shumë paisje tjera mjekëosre për njësitë përbërese të ShSKUK-së.

Tri (3) aktivitetet e planifikuara të kësaj objektive janë realizuar me sukses;

- Prioritizimi i pajisjeve mjekësore dhe instrumenteve të domosdoshme për punë

Me qëllim të koordinimit më të mirë të këtij aktiviteti, identifikimit dhe prioritizimit të paisjeve mjekësore në ShSKUK, gjatë vitit 2021 ka funksionuar një komision profesional i cili në bashkëpunim me sektorin për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore të QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme ka koordinuar aktivitetet për të siguruar pajisje mjekësore të domsdoshme për menaxhimin e pandemisë COVID-19, si dhe sigurimin e paisjeve mjekësore të domsodoshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimerve shëndetësore në kuadër të njësive përbërëse të ShSKUK-së. Ky komision, poashtu ka koordinuar edhe

aktivitetet me donatorët si dhe me MSH në paraqitjen e kërkesave të ShSKUK-së dhe sigurimin e distribuimit të paisjeve mjekësore nëpër nëjsitë e ShSKUK-së.

- Specifikimi i pajisjeve mjekësore dhe instrumenteve për punë

Bazuar në nevojat dhe kërkesat e paraqitura nga ana e njësive përbërëëse të ShSKUK-së në kuadër të planifikimeve të rregullta të tyre, por edhe të nevojave emergjente të paraqitura si pasojë e pandemisë COVID-19 në kohë optimale është bërë identifikimi, prioritizimi dhe specifikimi i paisjeve të domsodoshme mjekësore; janë hartaur listat me nevojat për paisje mjekësore sipas llojit dhe sasisë së paisjeve, janë prezantuar këto lista/kërkesa me kohë tek donatorët dhe MSh si dhe është bërë distribuimi racional sipas nevojave të njësvie përbërëse të ShSKUK-së. Natyrisht, një numër i kosniderueshëm i paijeve mjekësore është siguruar edhe përmes buxehtit të ShSKUK-së.

Llista me paisjet mjekësore dhe të gjitha produktet tjera të përfituara donacion nga ana e ShSKUK-së, që në vlerë financiare në total arrijnë shifrën prej rreth 15 milion Euro (14.710.702 Euro) është bashkangjitur si shtojcë e kërij raporti (shtojca nr.1).

- Blerja dhe funksionalizimi/përdorimi i paisjeve mjekësore dhe instrumenteve për punë

Gjatë vitit 2021 është arritur të sigurohen numër i mjaftueshëm i pasisjeve mjekësore dhe materialit tjetër mjekësorë për menaxhimin e pandemisë COVID-19, si dhe një numër i konsiderueshëm i paisjeve tjera mjekësore. Kështu, tashmë të gjitha SP janë të pajisura me CT aparate, me mamografa digjital, X-ray digjital mobil, por janë siguruar edhe shumë paisje tjera mjekësore [përfshirë aparatura të Ultrazërit, aparatura për nevojat e laboratoreve për analiza biokimike, hematologjike, gazore, patologjike, aparaturave endoskopike, etj..Krahas sigurimit të aparaturave të reja mjekësore janë vënë në funksion edhe paisje mjekësore të lëna pasdore për vite me radhë, si psh. funksionalizimi i aparaturës për studimim elektrofizioligjik të zemrës në Klinikën e Kardiologjisë, funksionalizimi i aparatit të brachiterapisë në Klinikën e Onkologjisë, CT kabineti në SP të Vushtrisë, etj.. Me përjashtime të rralla kur për arësye të ndryshme ka ndodhë që ndonjë aparaturë përkohësisht të del jashtë funksionit, mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i paisjeve mjekësore gjatë vitit 2021 është realizuar sipas planit.

VI. OBJEKTIVA VI: Përmirësimi dhe zgjerimi i ambienteve spitalore –

Investimet kapitale

Investimet kapitale janë ndër aktivitetet kryesore të organizatës; në këtë kuadër, për vitin 2021 në nivel të ShSKUK-së ishin të planifikuara 10 aktivitete – projekte të mëdha të investimeve kapitale, nga të cilat 8 janë realizuar plotësisht, 1 pjesërisht dhe 1 në proces të realizimit.

- Përfundimi i punimeve të ndërtimit dhe funksionalizimi i Spitalit të Fëmijëve (EBA)

Ndërtimi i Spitalit Kirurgjik Pediatrik në QKUK kishte filluar para rreth 6-7 viteve, donacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Ceremonia e dorëzimit të këtij spitali u organizua nga Zyra e Presidentes së Kosovës më 15 Shtator 2021, në koordinim me donatorin – Emiratet e Bashkuara Arabe. Megjithatë, për shkak të mos përfundimit të të gjitha procedurave administrative dhe mos pranimit teknik të objektit nga ana e komisioneve profesionale të themeluarë nga MSh, ky objekt nuk ka arritur të funksionalizohet gjatë vitit 2021, dhe pritet që kjo të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2022. Duhet rikujtuar, se në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare MSh kishte themeluar dy komisione për implementimin e këtij projekti: Komitetin e Lartë Drejtues të Projektit, dhe Njësinë Implementuese të Projektit. Ky objekt i ri shëndetësorë pritet të ofrojë shërbime gjithëprfshirëse dhe të integruara për fëmijët.



Spitali modern për fëmijë, donacion nga EBA, inaugurimi – Shtator 2021

Ambiente spitalore moderne, paisje të sofistikuara mjekësore.

- Ndërtimi i Objektit Spitalor për Nëna dhe Fëmijë në Prizren-Vazhdim

  Gjatë vitit 2020 ka filluar ndërtimi i Objektit Spitalor për Nëna dhe Fëmijë, një investim kapital ky me mjete buxhetore të ShSKUK-së. Vlera financiare e këtij objekti është rreth 4.9 milion Euro, dhe ndërtimi pritet të përfundojë brenda vitit 2023. Gjatë vitit 2021 ka vazhduar ndërtimi i objektit sipas planit dianmik të paraparë ku janë realizaur punë dënrtimore në vlerë prej rreth 1 milion Euro (1,033,498 Euro).

- Fillimi i ndërtimit të Klinikës së Nefrologjisë dhe Hematologjisë.

  Edhe pse QKUK ka siguruar buxhetin për ndërtimin Klinikës së Nefrologjisë dhe Hematologjisë, poashtu edhe projekti detal është hartuar dhe është dorëzuar aplikacioni për leje të ndërtimit, kjo nuk është arritur të sigurohet për shkak të mosdefinimit të kufijve (mungesës së përcaktimit të vijave kufitare) të parcelave të QKUK-së. Sipas kërkesës së Komunës së Prishtinës, ShSKUK bazuar në legjsilacionin në fuqi ka kontraktuar një kompani private profesionale për përcaktimin e kufijve të parcelave të QKUK-së e cila është në proces. QKUK që nga paslufta i ka të padefinuar kufijtë e parcelave të saja.

- Mbindërtimi në Kardiologji – salla e kateterizimit në SP të Prizrenit-Vazhdim

  Në SP të Prizrenit ka vazhduar mbindërtimi për kardiologji i sallës së kateterizimit ku parashihet të funksionalizohet laboratori i kateterizimit. Punët ndërtimore kanë vazhduar sipas dinamikës së planifikuar dhe gjatë vitit 2021 janë realizuar punë ndërtimore në vlerë financiare rreth 230 mijë Euro (230,153Euro). Mbindërtimi i këtij laboratori të kateterizimit për kardiologji pritet të përfundojë në vitin 2022.



Punimet në ndërtimin e laboratorit të kateterizimit në SP në Prizren

- Përfundimi i Punimeve në objektin e QKMS dhe KMFR në QKUK - Vazhdim

  Gjatë vitit 2021 është arritur të përfundojnë punimet në objektin e Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive (QKMS) dhe Klinikës së Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim (KMFR). Për shkak të nevojës së madhe që një pjesë (lamelë) e këtij objekti u shfryëzua për trajtimin e pacientëve me COVID-19 (u ridestinua për këtë qëllim), dinamika e punimeve u përshpejtua dhe u arrit që punimet të përfundojnë madje edhe përpara afatit të paraparë me dinamikë të planit të punës. Ridestinimi i këtij objekti për trajtimin e pacientëve me COVID-19, edhe për faktin e disponueshmërisë së rezervoarit të oksigjenit të lëngshëm dhe shtrirjen e rrjetit të oksigjenit qendror ka lehtësuar tejmase menaxhimin me pandeminë COVID-19.

- Ndërtimi i Aneksit të Klinikës së Ortopedisë në QKUK-Vazhdim

  Në kuadër të Klinikës së Ortopedisë ka vazhduar renovimi dhe zgjerimi me mbindërtim i ankesit të kësaj klinike – bllokut operativ me 4 salla të reja për operacione. Punimet e këtij aneksi, për shkak të paraqitjes së punëve të paparashikuara, për një kohë janë stopuar gjatë vitit 2021; pas kryerjes së procedurave konform legjislacionit në fuqi kanë vazhduar punimet dhe pritet që ndërtimi i këtij blloku operativ të përfundojë brenda vitit 2022. Ndërtimi i këtij ankesi – blloku operativ do të sigurojë kushte shumë më të mira për Klinikën e Ortopedisë dhe do të mundësojë adresimin / zvogëlimin e listave të pritjes së pacientëve për operacione, ne veçanti ato për protezat e gjurit dhe kërdhokullës.

- Adaptimi (ndërtimi) i hapësirave për IVF dhe laboratorin citogjenetik në KOGJ-Vazhdim

Në kuadër të Klinikës Obstetrike-Gjinekologjike në QKUK parashihet që të fillojnë shërbimet shëndetësore për frytnimin e asistuar artificial – in vitro fertility (IVF) dhe laboratori për ekzaminime-analiza citogjenetike. Adatpimi dhe renovimi i hapësirave (repartit) për IVF dhe laborator citogjenetik ka përfunduar gjatë vitit 2021. Sigurimi i paisjeve mjekësore për këtë qëllim mbetet sfidë në mungesë të mjeteve financiare. Vlera e përafërt e këtyre paisjeve është vlerësuar rreth 1.2 milion euro. Menaxhmetni i ShSKUK-së ka kërkuar mundësinë e sgurimit të këtyre paisjeve përmes donatorëve, por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje pozitive. Kërkesa për buxhetim të këtyre paisjeve mjekësore në kuadër të buxhetit të ShSKUK-së për vititn 2021 nuk ishte miratuar nga ana e Qeverisë e poashtu as me Ligjin e Buxhetit për vititn 2022 nuk është arritur të sigurohen këto mjete financiare.

Punimet në renovimin e hapësirave të Klinikës së Gjinekologjisë për shërbimin e IVF dhe laboratorit citogjenetik

- Përfundimi i punimeve në hapësirat e angiografisë në Klinikën e Neurologjisë-Vazhdim

Punimet rreth adaptimit dhe renovimit të hapësirave për anigografi në Klinikën e Neurologjisë kanë vazhduar dhe përfunduar sipas planit dinamik të paraparë në vititn 2021. Aparati i ri i angiografisë është instaluar dhe është vënë në funksion.



- Rregullimi i nyjeve sanitare në hapësirat e QKUK dhe njësive tjera të ShSKUK-së

Mirëmbajtja e regullt dhe rregulllmi i nyjeve sanitare është një aktvitet i rëndësishëm për sigurimin e një ambienti të pastër dhe krijimin e kushteve më të mira për pacientët e spitalizuar në njësitë përbërëse të ShSKUK-së. Krahas mirëmbajtjes së rregullt të nyjeve sanitare, e cila mirëmbajtje ka nevojë të përmirësohet në vazhdimësi, gjatë vitittë 2021 është arritur që në disa Klinika të QKUK dhe SP të renovoben në tërësi nyjet sanitare. Kështu, në Klinikën e Pulmologjisë në QKUK, me mbështetjen e MSh përmes projekteve huamarrëse është bërë renovimi komplet i të gjitha nyjeve sanitare. Në Klinikën e Onkologjisë nga një donatorë lokal privat janë renovuar në tërësi poashtu të gjitha nyjet sanitare të kësaj klinike. Në Spitalet Përgjithshme, në kuadër të renovimeve dhe adaptimeve të hapësirave spitalore janë renovuar në tërësi nyjet sanitare nëpër repartet përkatëse, si psh. në kabinetin e Radiologjisë në SP të Ferizajit, në Repartin e Emergjencës në SP të Gjakovës, në Repartin e Kirurgjisë në SP të Prizrenit, në disa reparte në SP të Gjilanit, etj,.

- Furnizimi me inventar medicinal dhe administrati në SHSKUK

Inventarizimi i vazhdueshëm i njësive përbërëse të ShSKUK-së si me inevntar medicinal, poashtu edhe me atë administrativ është aktivitet i rregullt vjetor. Megjithatë, gjatë vitit 2021, për shkak edhe të pandemsië COVID-19 këtij aktiviteti i është kushtuar vëmendje e posaçme, sidomos në sigurimin e mjaftueshëm të shtretërve të rinjë dhe inventarit tjetër të nevojshëm për paienteë, përfshirë tavolinat [ërcjellëse të shtretërve, dollape, etj. Kështu me sigurimin e shtretërve të rinjë, qoftë me mjete vetanake të ShSKUK-së, qoftë përmes donacioneve, ShSKUK ka arritur që rreth 50% të të gjithë shtretërve tani i ka më të rinjë se 2 vjet.

VII. OBJEKTIVA VII: Reforma administrative

Si një proces gjithmomë sfidues për të gjitha organizatat, edhe për ShSKUK-në procesi i reformës administrative rezultoi të jetë sfidues, qoftë për shkak të pandemisë COVID-19, qoftë për shkak të domosdoshëmrisë dhe kërkesave ligjore për përfshirjen në këtë proces të institucioneve tjera, në veçanti të MSh. Nga 7 aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj objektive të gjitha kanë filluar të implementohen, janë në proces por që nuk është arritur të përfundohen gjatë vitit 2021.

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj objekitve të cilat kanë filluar gjatë vitit 2021 janë si më poshtë:

- Plotësim ndryshimi i Statutit të ShSKUK

Është themeluar grupi punues, është draftuar drafti dhe është në procedurë.

- Plotësim ndryshimi i Statutit të QKUK

Është themeluar grupi punues, është hartuar drafti, është në procedurë.

- Plotësim ndryshimi i Statutit të QSKUK

Është hartuar drafti final, pritet miratimi.

- Plotësim ndryshimi i Stautit të Spitaleve të Përgjithshme

Për shkak të pandemisë COVID-19, anagzhimit të stafit ne mënaxhimin e pandemisë nuk është realizuar ky aktivitet;

- Rregullorja për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës;

Është përgatitur drafti final, pritet miratimi

- Hartimi i Rregullores për menaxhimin e ankimimeve të pacientëve

Për shkak të pandemisë COVID-19, anagzhimit të stafit ne mënaxhimin e pandemisë nuk është realizuar ky aktivitet;

- Avokimi-nevoja për plotësim ndryshim të Ligjit të prokurimit për sektorin shëndetësor
Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar plotësim-ndryshimin e Ligjit të Prokurimit.

VIII. OBJEKTIVA VIII: Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve spitalore

Edhe pse është vendosur si objektiva e fundit e planit të veprimit, për nga rëndësia paraqet një ndër objektivat me rëndësi të veçantë. Pandemia COVID-19 sigurisht se ka ndikuar në realizimin e kësaj objektive, sidoqoftë nga 6 aktivitetet e planifikaura 4 nga to janë realizuar, 1 është në proces dhe 1 nuk është arritur të fillojë së realizuari.

- Kontrolli sistematik i personelit shëndetësor dhe mbështetës

Ky aktivitet për shkak të pandemisë COVID-19 nuk ka filluar së implementuari.

- DDD i hapësirave/infrastrukturës spitalore

DDD i hapësirave –ambienteve spitalore në të gjitha njësitë përbërëse të ShSKUK ka vazhduar dhe është realizuar sipas planit.

- Furnizimi me çarshafa, mbulesa dhe mbështjellës të jastëkut për pacient

Edhe pse jo në sasi të mjaftueshme, kryesisht për shkak të limitimeve buxhetore, furnizimi me çarshafa, mbulesa dhe mbështjellës e batanije ka vazhduar gjatë vitit 2021

- Sigurimi i uniformës dhe mbathjes së mjaftueshme për stafin shëndetësor dhe mbështetës

Për shkak të kufizimeve buxhetore, gjatë vitit 2021 është arritur të sigurohet unifiorma kryesisht për stafin mbështetës-shërbimet teknike, dhe një pjesë e vogël në disa spitale edhe për personelin shëndetësorë. Megjithatë, gjatë gjithë vitit është siguruar sasi e mjaftueshme

e uniformave – paisjeve mbrojtëse personale për gjithë personelin shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë.

- Hartimi i Procedurave Standarde Operative për parandalim dhe kontrollë të infeksioneve spitalore

  Me mbështetjen e kolegëve nga IKSHPK ka fillau hartimi i Procedurave Standarde Operative për blloqet operative dhe njësitë e kujdesit intenziv. Këto Procedura janë duke u hartuar në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me profesionistët e fushës.

- Krijimi i njësisë për pastrim dhe dezinfektim të shtretërve në QKUK

  Për shkak të paqartësive ligjore dhe mungesës së përvojës në këtë fushë, nuk është arritur të fillohet me implementimin e këtij aktiviteti. Megjithatë pastrimi dhe dezinfektimi i shtretërve ka vazhduar sipas metodave të mëhershme. Ndërkohë ShSKUK ka arritur të sigurojë që rreth 50% të të gjithë shtretërve që tani ka në dispozicion të jenë më të rinjë se 2vjet.

1. Struktura e të punësuarve në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar te Kosovës

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës në strukturën organizative në vitin 2021 kishte gjithsej 7,225 punëtorë. Sipas kualifikimeve profesionale, Mjekë specialistë janë 1.557 apo 23%, kurse stafit infermier/e janë 3.926 apo 59% dhe punëtorë jo shëndetësor adminsitrativ dhe teknik nga lëmit e ndryshme janë gjithsejt 1.188 apo 18% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në SHSKUK.

Po ashtu kanë qenë të angazhuar edhe 70 punonjës tjerë pa pagesë në nivel të SHSKUK-së.



Figure 1 Struktura e të punësuarve në ShSKUK

Performanca e punës në SHSKUK Janar- Dhjetor 2021

Ditë shërimi	Nr. i pacientëve të shtrirë	Nr . i operimeve	Vizita ambulantore	Vizita tjera diagnostike	Shërbime laboratorike	Shërbime tjera/apo te veçanta	Nr. i Dializa	Shërbime Radiologjike	Nr. i Lindje
742.99	145.567	33.666	1.223.415	568.042	3.789.875	396.849	117.431	371.166	19.682

















2. Shërbimet e realizuara në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës - 2021

Gjatë vitit 2021 në kuadër të SHSKUK-së, edhe për kundër sfidave me situatën e pandemisë Covid-19, janë ofruar gjithsejt 6.5 milion shërbime. Nga këto shërbime të kryera janë: 742.994 ditë shërimi me gjithsejt 145.567 pacientë të spitalizaur. Nga pacientët e shtrirë janë realizuar 33.666 operime në nivel të njësive të ShSKUK-së, janë realizuara 1.223.415 vizita ambulantore, dhe 568.042 vizita tjera diagnostike, kurse janë ofruar 3.789.875 shërbime laboratorike (parametra laboratorikë) për 562.349 pacientë. Numri i lindjeve në njësitë e SHSKUK-së, është 19.682, kurse fëmijë të lindur 20.281; janë kryer 117.431, shërbime të hemodializës. Gjithashtu janë kryer 405.586 shërbime tjera apo të veçanta, mvarësisht nga lloji i shërbimit dhe njësisë.
Mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë është 5.1 ditë, kurse shfrytëzimi mesatara i kapaciteteve në SHSKUK është 51%.

Fakte të paraqitura në numra.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës gjatë viti 2021:

- numri i pacientëve të spitalizuar është 71.623 me 418.847 ditë shërimi;
- 18.592 pacientë i janë nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjike;
- 8.737 lindje, prej tyre 3.224 lindje me operacion; nr. i fëmijëve të lindur - 8982;
- janë ofruarar 416.402 vizita ambulantore dhe 164.452 vizita tjera diagnostike;
- janë kryer 1.806.540 shërbime /parametra laburatorik për 388.673 pacientë;
- janë realizaur 36.327 seanca të hemiodializës;
- 174.908 shërbime radiologjike;
- 396.849 shërbime tjera - apo të veçanta;
- mesataraje e ditëve të shërimit në QKUK është 5.8 ditë;
- shfrytëzimi i kapaciteteve të shtretërve- 59%.

Spitalet e Përgjithshme (7 SP)

- 73.888 pacientë të spitalizaur me 323.782 ditë shërimi;'
- numri i pacientëve të operuar është 15.074;
- 10.945 lindje, prej tyre 3,694 me operacion; nr. i fëmijëe të lindur 11.299;
- janë ofruar 715.185 vizita ambulantore dhe 372.328 vizita tjera diagnostike;
- janë kryer 1.891.539 shërbime / parametra laboratorik për 166.791 pacientë;
- janë realizuar 81.104 shërbime të hemodializës;
- 190.374 shërbime radiologjike;
- mesatarja e ditëve të shërimit 4.4 ditë
- shfrytëzimi i kapaciteteve të shtretërve është 45%.

QKSUK (Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës)

- janë kryer gjithsejt 45.073 vizita të para dhe vizita kontrolluese;
- shërbime tjera të veçanta - shërbimet specifike janë kryer 141.593, dhe;
- janë kryer 61.526 aktivitete tjera jashtë Prishtinës.

Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor me 8 njësi në nivel vendi

- janë realizuar 5.817 vizita shtëpiake;
- 11.839 qëndrime ditore;
- 22.503 vizita ambulantore, dhe;
- janë kryer 70.353 terapi okupuese, art, sport dhe shërbime tjera.
- në total, janë ofruar 110.512 shërbime;

QKMP (Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë)

- janë realizuar 17.153 vizita ambulantore
- 31.262 vizita tjera diagnostike apo shërbime të veqanta;
- 91.796 shërbime / parametra laboratorik për 6.885 pacientë
- 5.219 shërbime/ekzaminime radiologjike
- në total, gjatë vitit 2021 në QKMP në Gjakovë janë ofruar 141.992 shërbime.

QKMS (Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive)

- gjatë viti 2021 janë kryer 202 vizita specialistike;
- janë realizaur 313 terapi fizikale
- janë kryer 14.208 shërbime specialistike.

QKTK (Qendra Kombëtare e Telemjekësisë Kosovare)

- janë realizuar gjithsejt 62 aktivitete, përfshirë:
    - trajnime profesionale;
    - telekonferenca;
    - publikime shkencore,
    - EVP, etj.;
- numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete është 6.295, prej të cilëve:
    - 2,534 mjek/specialist
    - 798 mjek në specializim
    - 2.087 infermier
    - 351 studentë, dhe;
    - 525 profesionistë tjerë shëndetësorë;
- në bibliotekën elektornike janë realizuar 6.897 vizita (shërbime), prej të cilave:
    - 3.544 personel shëndetësorë (mjekë specialist, specializant, infermierë) dhe;
    - 3.350 studentë.

3. Struktura e të punësuarve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës QKUK

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në listën e pagave janë gjithsejtt 3,402 punonjës. Sipas strukturës profesionale nga ky numër i të punësuarve kemi: Staf jo shëndetësor janë 511 punonjës apo 15%, Infermierë 2069 punonjës apo 61% dhe Mjekë Specialistë janë gjithsejtt 822 apo 24% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve ne QKUK-së.



Figure 3 Numri i të punësuarve në QKUK sipas përgaditjes profesionale



Figure 4 % e të punësuarve sipas profesioneve

Performanca e njësive të QKUK

Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	Nr. i të operuarve	Vizita ambulantore	Vizita tjera diagnostike	Shërbime laboratorike	Nr i Dializa	Nr i Anestezioneve	Shërbime tjera/apo të veçanta	Shërbime Radiologjike	Nr. i Lindje	Sëmundje malinje-raste të reja	Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve
418,847	71,623	18,592	416,402	164,452	1,806,540	36,327	17,094	396,849	174,908	8,737	1,626	59%













4. Performanca në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës gjatë vitit 2021 kanë qenë 418.847 ditë shërimi, me 71.623 pacientë të shtrirë. Nga këta pacientë të shtrirë janë operuara 18.592 pacientë, janë ofruar 416.402 shërbime ambulantore dhe 164.452 vizita tjera diagnostike, ndërsa janë kryer 1.806.540 shërbime laboratorike(parametra) për 388.673 pacientë. Në Klinikën e Radiologjisë dhe Mjekësin Nuklerare janë kryer 174.908 shërbime radiologjike të ndryshme (MRI, CT, Ultrazë, Radiografi, Angjiografi, Mamografi, Sintigrafi të pjesë të nryshme trupore, Densitometri të kockave dhe shërbime tjera radiologjike) dhe ishin kryer 36.327 shërbime të dializës në Klinikën e Nefrologjisë dhe Klinikën e Pediatrisë në QKUK.

Numri i lindjeve në QKUK ishte 8,737 në përgjithësi, 3,224 lindje me operim, ndërsa fëmijë të lindur ishin 8,982.

Në klinikën e Kardiologjisë dhe Kardiologjisë Invazive janë kryer 2,524 koronografi, ndërsa janë vendosur 1,450 stenta dhe janë kryer 252 operacione në këtë klinikë.

Në klinikën e Anestezionit dhe Reanimacionit janë 16,083 ditë shërimi me 6.404 pacientë të shtrirë, ndërsa janë kryer 66.792 shërbime ambulantore dhe janë kryer 17.094 anestezione nëper klinika të ndryshme.

Në klinikën e Onkologjisë kishte 2.182 ditë shërimi me 356 pacientë të shtrirë dhe 40.571 vizita ambulantore gjithashtu janë dhënë 29.603 terapi me citostatik. Si raste të reja janë paraqitur 1626 pacientë. Ndër ta janë 398 raste me sëmundje malinje të gjirit, 213 raste me sëmundje të mushkrive, 391 raste me sëmundje të traktit gastrointestinal, 419 raste me sëmundje urogjenitale dhe gjinekologjike dhe 205 sëmundje tjera të kokës, qafës, inde të buta, SNQ dhe sëmundje tjera.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë ishte 5.8 ditë, kurse shfrytëzimi mesatara I kapaciteteve në QKUK është 59%

4.1. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës- QKUK-së

Nr	QKUK	Reparti	Nr i Shtretërvev	Ditë shërimi	Nr. i të spitalizuarve	Nr.i të operuarve	Vizita ambulantor	Vizita tjera diagnostike	Shërbime laboratorike	Seanca të Hemodializ.	Anestezione	Shërbime tjera/apo te vecanta	Shfrytëzimi i kapaci-teteve	Sherimi
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	13	382	73641	15585	5725	2548	31729				122678	53%	**4.73**
2	Klinika e Dermatovenerologj.	3	30	4407	442		11720	401				5667	40%	**9.97**
3	Kirurgjia Abdominale	5	69	14092	2478	1454	32 72	6866				2007	56%	**5.69**
4	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	1	21	4356	600	830	2631	33				1079	57%	**7.26**
5	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	4	104	16139	1907	1695	22308	1876				5277	43%	**8.46**
6	Klinika e Kirurgjisë Torakale	1	26	6088	758	405	2660	343				2092	64%	**8.03**
7	Klinika e Gastroenterologjisë	3	33	7680	956		4622	8525				10235	64%	**8.03**
8	Klinika e Hematologjisë	1	25	4183	550		3772	4095				6147	46%	**7.61**
9	Klinika e Neonotalogjisë	1	180	38658	9495	0	2659	1027				1408	59%	**4.07**
10	Klinika infektive	7	120	25333	2177		18285	4598				6488	58%	**11.64**
11	Klinika e Syve	3	41	10916	2376	1836	22614	2015				5666	72%	**4.59**
12	Klinika e Nefrologjisë	1	18	4050	433		2418	2911		36230		6010	62%	**9.35**
13	Shërbimi i Ortoprotet	1					1263					1263		
14	Klinika e Pulmologjisë	4	68	25334	2089		22165	9670				337	102%	**12.13**

15	Klinika e Kardiologjisë	3	61	12894	5569		7038	14468				3503	58%	**2.32**
16	Klinika e Pediatrisë	9	151	47961	7104		18056	31099		97		20413	87%	**6.75**
17	Klinika e Endrokrinologjisë	1	24	5087	827		9463	2370				17650	58%	**6.15**
18	Klinika e Anestezisë & Mjekimit Intenziv	3	60	16083	6404		66792				17094	0	73%	**2.51**
19	Klinika e ORL-së	5	53	12476	1646	1521	16816	160				5347	64%	**7.58**
20	Klinika e Neurologjisë	1	58	15426	1922		8686	10427				5021	73%	**8.03**
21	Klinika e Biokimisë Mjekësore	1							1806540					
22	Shërbimi i Mjekësisë Nukleare	1					665	6491				7431		
23	Klinik e Emergjencës	1	19				65344					4904	0%	
24	Klinika e Fiziatrisë	1	15	2344	97		6409	128				94870	43%	**24.16**
25	Klinika e Kirurgjisë Plastike	1	20	3676	523	1267	4845	1103				8628	50%	**7.03**
26	Klinika e Neurokirurgjisë	1	24	5172	711	509	3121	1884				2400	59%	**7.27**
27	Klinika e Urologjisë	1	24	5245	1079	925	4806	2511				186	60%	**4.86**
28	Klinika e Onkologjisë	1	13	2182	356		40571	2309				29603	46%	**6.13**
29	Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologji Invazive	1	28	11400	777	252	3214	2011				2056	112%	**14.67**
30	Klinika e Psikiatrisë	4	41	8724	558		13071	575				1869	58%	**15.63**
31	Klinika e Radiologjisë	1						168417						
32	Klinika e Reumatologjisë	1	26	4979	952		6641	1890				102	52%	**5.23**

33	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	1	37	6196	1695	1134	6745	27				14	46%	**3.66**
34	Klinika Kirurgji Vaskulare	1	24	5731	1229	1039	6392	1535				1008	65%	**4.66**
35	Alergologjia	1	11	1816	254		3452	1375					45%	**7.15**
36	Instiuti i Psikiatrisë Forenzike	3	36	13574	423		516	393				126	103%	**32.09**
37	Insitututet Paraklinike	1					822	15459				7007		
	Mjekësia Sportive (Infektiva II)	1	95	8230	1033			639					24%	**7.97**
	Total	**91**	**1946**	**418847**	**71623**	**18592**	**416402**	**339360**	**1806540**	**36327**	**17094**	**388492**	**59%**	**5.85**

Table 1 Shërbimet e ofruara në QKUK-së, për secilen nga klinikat, numri e shërbimeve të kryera dhe shfrytëzimi I kapaciteteve

Shfrytëzimi i kapaciteteve në QKUK-së, mesatarashit është 59% dhe gjatësia mesatare e shërimit është 5.8 ditë.
Gjatë vitit 2021 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nga klinika me më së shumti pacient të shtrirë është Klinika e Gjinekologjisë me gjithsej 15.585 pacient të shtrirë dhe me 73.641 ditë shërimi, dhe 5.725 pacient të operuar, përveç shumë shërbimeve specifike të realizuara nga kjo klnikë, gjatë kësaj periudhe pune në këtë klnikë janë realizuar 8.737 lindje, nga këto lindje 3.224 lindje janë realizuar me ndërhyrje cezariane, nga këto lindje kemi 8.982 fëmijë të lindur vetëm në Klnikën e KOGJ, dhe të njejtit janë transferuar në Klinikën e Neonatologjisë për trajtim
Klinika e Neontaologjisë në QKUK, gjithsej kishte 9.495 pacient të shtrirë me gjithsej 38.658 ditë shërimi.
Klinika e Pediatrisë, kishte gjithsejtt 7.104 pacientë të shtrirë me gjithsejt 47961 ditë shërimi, dhe po ashty kanë kryer 97 dializa.
Klinika e Anestezionit dhe Reanimacionit ka kryer 17.094 anestezione, numri i pacientëve të shtrirë 6.404 dhe 16.083 ditë shërimi.
Klinika e Nefrologjisë ka kryer 36.230 dializa dhe kishte 433 pacientë të shtrirë,
Klinika e Kirurgjisë Abdominale ka realizuar gjithsej 1.454 operime të ndryshme, dhe kishte 2478 pacientë të shtrirë.
Klinika e Ortopedisë kishte 1695 pacient të operuar, 1907 pacientë të shtrirë dhe me 16139 ditë shërimi, në këtë klinikë janë realizuar.

Klinika e Syve ka realizuar 1836 operime gjithsej, në Klinikën e ORL-së, janë realizuar 1521 operime. Klinika e Kirurgjisë Plastike 1267 operime. Kirurgjia e Kirurgjisë së Fëmijëve 1134, Klinika e Kirurgjisë Vaskulare 1039 operime, Klinika e Urologjis 925 operime. Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale 830 operime, Klinika e Neurokirurgjisë 509 operime. Kirurgjia Torakale 405 operime dhe Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë invasive janë kryer 252 operime.

4.2. Shfrytëzimi i kapaciteteve në klinikat e kirurgjisë



Figure 5 Përqindja e shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve në klinikat kirurgjike

Kirurgjia Vaskulare ka shfrytëzuar të përqindjes prej 65.4%. Kirurgjia e Fëmijëve ka shfrytëzueshmëri prej 45.9%, Kardiokirurgjia dhe Kardiologji Invazive ka shfrytëzueshmëri prej 111.5%.

Klinika e Urologjisë ka shfrytëzueshmëri prej 59.9%, Klinika e Neurokirurgjisë ka shfrytëzueshmëri prej 59%, Klinka e Kirurgjisë Plastike ka shfrytëzueshmëri prej 50.4%, Klinika e ORL ka shfrytëzueshmeri prej 64.5%, Klinika e Syve ka shfrytëzueshmëri prej 31.2%, Kirururgjia Torakale ka shfrytëzueshmëri prej 64.2%, Klinika e Ortopedisë ka shfrytëzueshmëri prej 42.5%, Kirurgjia Maksiollofaciale ka shfrytëzueshmëri prej 56.8%, Kirurgjia Abdominale ka shfrytëzueshmëri prej 56% dhe Klinika Obstetrike Gjinekologjike ka shfrytëzueshmëri prej 52.8%. Klinika e Anestezionit dhe Reanimacionit ka shfrytëzueshmëri të përqindjes prej 73.4% të kapaciteteve.

4.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve në klinikat internistike dhe klinikat tjera



Figure 6 Përqindja e shfrytëzueshmërisë së kapacitetetev në klinikat internistike dhe klinikat tjera

Shfrytëzimi i kapaciteteve në vitin 2021 në degët internistike dhe klinikat tjera me përqindje më të lartë prin Instituti i Psikiatrisë Forenzike me 103% të kapaciteteve dhe gjatësia mesatar e shërimit 32.09 për ditë shërimi dhe kishte 423 pacientë të shtrirë. Pastaj prin Klinika e Pulmologjisë me 102% të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjatësia mesatar e shërimit është 12.127 ditë shërimi dhe numri i pacientëve të shtrirë ishte 2089 pacientë dhe total ditë shërimi kishte 25.334 ditë sherimi në 68 shtretër.

Klinika e Pediatrisë ka shfrytëzim të kapaciteteve 87%, dhe me gjatësi mesatare të shërimit 6.751 për ditë. Kjo klinikë kishte 7.104 pacietë të shtrirë dhe 47.961 ditë shërimi nga 151 shtretër.

Klinika e Neruologjisë shfrytëzueshmëri të kapaciteteve gjatë vitit 2021 kishte 73% apo 8.02 ditë mjekimi për pacientë. Kjo Klinikë kishte gjithsejtt 1.922 pacientë të shtrirë dhe 15.426 ditë shërimi nga gjithsejtt 58 shtretër. Klinika e Gastroenterologjisë ka shfrytëzim të kapaciteteve prej 64% dhe 8.03 ditë mjekimi për pacientë. Kjo klinikë kishte 956 pacientë dhe 7.680 ditë shërimi. Klinika e Nefrologjisë ka 62% të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjatësia mesatare e shërimit 9.35 për pacientë. Nga 18 shtretër sa ka gjithsejt kanë qenë të shtrire 433 pacientë dhe 4050 ditë shërimi.

Klinika e Neonatologjisë ka shfrytëzueshmeri të kapaciteteve 59% dhe gjatësi mesatare e shërimit 4.07 ditë për pacientë. Numri i pacientëve të shtrirë ishte 9.495 dhe gjithsejt 38.658 ditë shërimi.

Ndersa në bazë të raporteve kemi katër klinika të cialt kanë pasë shfrytëzueshmërin e kapacitetetev me 58%. Klinika e Psiakrisë, dhe mesatare për ditë shërimi 15.63. Klinika Infektive ka 58% të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe mesatare e sherimit është 11.63. Ka pasur gjithësjet 2.177 pacientë të shtrirë dhe 25.333 ditë shërimi për 120 shtretër. Klinika e Endokrinologjisë ka shfrytëzueshmëri të kapaciteteve 58% dhe mesatarja e shërimit është 6.15 për pacientë. Kjo klinikë kishte 827 pacientë të shtrirë dhe 5.087 ditë shërimi në 24 shtretër. Klinika e Kardiologjisë ka shfrytëzueshmëri të kapaciteteve 58% dhe mesatare e ditëve shërimit është 2.31. Kjo klinikë ka pasë gjithsejt 5.569 pacientë të shtrirë dhe 12.894 ditë shërimi.

Klinika e Reumatologjisë ka shfrytëzueshmëri të kapaciteteve 52% dhe mesataraja e shërimit është 5.23 për ditë. Gjatë vitit 2021 kishte gjithsejtt 952 pacientë dhe 4.979 ditë shërimi.

Klinika e Onkologjisë dhe Hematologjisë kanë shfrytëzueshmëri të kapaciteteve prej 46%.

Klinika e Alergologjisë ka shfrytëzueshmëri të kapaciteteve prej 45% dhe mesatarja shërimit është 7.15 ditë për pacientë.

Klinika e Fiziatrisë ka shfrytëzueshmëri prej 43% të kapaciteteve dhe mesatare e sherimit është 24.16. Kjo klinik ka pasur gjithsejtt 97 pacientë të shrirë dhe 2.344 ditë shërimi.

Klinika e Dermatovenerologjisë ka pasur gjithsejt 40% të shfrytëzueshmëris së kapaciteteve dhe mesataraja e shërimit është 9.97. kjo klinika ka trajtuar 442 pacientë të shtrirë dhe 4.407 ditë shërimi.

Pjesë e këtij vlerësimi në raportin e punës për vitin 2021 është edhe Mjekësia Sportive-II, I detikuar për trajtimin e pacientëve me Covid-19. Kjo njësi ka shërbyer vetëm në bazë të nevojave dhe sipas rrethanavve të paraqitura për shfrytëzim të këtij objekti. Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve është 24% dhe mesataraja e shërimit është 7.96 ditë. Kjo njësi kishtë 1.033 pacientë dhe 8.230 ditë shërimi për 95 shtretër që kishte.

Pra shfrytëzimi i kapaciteteve mesatare ne përgjithësi në klinika e QKUK-së është 59% dhe gjatësia mesatre e shërimit është 5.87 ditë shërimi.

5. Struktura kualifikuese në Spitalet e Përgjithshme

Në kuadër të SHSKUK-së, funksionojnë edhe shtatë Spitalet e Përgjithshme regjionale që operojnë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Numri i përgjithshëm i punëtorëve në Spitalet e Përgjithshme në kuadër të SHSKUK-së është gjithsej 3.302 punëtorë.



Figure 7 Numri I të punësuarve sipas structurës kualifikuese në Spitale e Përgjithshme

Prej tyre 1.893 janë të kuadrit infermierorë apo 57% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve.

Mjekë specialist janë 729 apo 22% e punëtorëve dhe punëtorë tjerë jo shëndetësor janë 680 punëtorë apo 21%. Në krahasim me vitin 2020 këte numri i punëtorëve thuajse ishte i njëjtë në vitin 2021.



Figure 8 Përqindja e të punësuarve në Spitalet e Përgjithshme

Burimet njerzore sipas profesioneve në Spitalet e Përgjithshme

Nr.	Specializimi	Spitali Gjilan			Spitali Ferizaj			Spitali Gjakovë			Spitali Prizren			Spitali Pejë			Spitali Mitrovicë			Spitali Vushtrri		
		Mjek specialist	Infermier	Jo shëndetësor	Mjek specialist	Infermier	Jo shëndetësor	Mjek specialist	Infermier	Jo shëndetësor	Mjek specialist	Infermier - fiziotera peut	Jo shendetësor	Mjek specialist	Infermier - fiziotera peut	Jo shendetësor	Mjek specialist	Infermier	Jo shëndetësor	Mjek specialist	Infermier - fiziotera peut	Jo shendetësor
1	Infektiva	6	11		2	3		2	8		5	11	3	1	8	1	1	7				
2	Kirurgjia	8	14		5	11		7	14	2	18	11	2	9	12	3	5	17		5	11	
3	Kardiokirurgjia																					
4	Kirurgjia e Femijeve													2								
5	Neurokirurgjia																					
6	Urologjia	4	10		3			5	5		8	7	1	5	7	1	2	9		1		
7	Torakale																					
8	Plastike																					
9	Vaskulare																					
10	ORL	8	11		4	1		1	5		11	8	2	4	4		2	10				
11	Oftalmologjia	4	5		4	1		1	5		6	7	1	3	5	1	5	9				
12	Gjinekologjia	13	37	4	6	24		14	45	1	19	47	7	12	24	2	8	27		7	15	
13	Neonatologjia	6	13		3	4		4	17		9	14		4	12	1	2	9				
14	Biokimia	5	12	1		7		3	16		2	21	3	4	22	2	1	10		2	6	
15	Mjekësia Nukleare																					
16	Pediatria	6	15		8	11		11	23		15	20	3	5	12	1	7	18		6	9	
17	Kardiologjia				6															2		
18	Nefrologjia QKUK/hemodializa SP	2	15	3		15		1	20	3	6	36	3	2	17	3	2	16				
19	Gastro dhe Hepatologji				3															4	1	
20	Endokrina				4			1												1		
21	Hematologji																					
22	Reumatologji				5			1												2		
23	Neurologji	3	15		1			5	12		4	11	1	6	10	1	4	10				
24	Njësia koronare	3	10					4	8		6	20		5	14	1						
25	Psikiatria	3	10		1			5	7		6	11	3	4	9	1						
26	Forenzika																					
27	Ortopedia	5	13		4	4		7	10	1	6	10	2	3	10	1	6	6				
28	Dermatovenerologjia	7	2		5	1		1	6		4	2	1	5	4		3	2		2		
29	Anestezioni dhe Mjekimi Intensiv	6	24		3	10		7	19		11	29	2	8	40	6	4	15		1	14	
30	Fiziatria	3	5		3			3	11		2	25	1	1	4	1		8		1	1	
31	Pulmologjia	5	15		2			2	10		6	11	1	4	9	2	2	9		1		
32	Emergjenca	4	30		1	27		4	18		6	24	4	2	24	1	4	8		4	13	
33	Maxillofaciale													4			6	19				
34	Onkologjia																					
35	Radiologji	4	15		3	8		3	10	1	8	9	1	3	12	1	3	11		6		
36	Institutet e patologjisë													2	2		2	11				
37	Alergologji Imunologji				1			2														
38	Interno	13	23		2	12		4	21		14	22	4	10	13	2	2	2		1	8	
39	Barnatorja		5		2	2		2	6		2	8	1	2	4	1	17	20			2	
40	Mikrobiolog/Toksikolog													2	4							
41	Ambulancat spec. blloku operativ		19	4		20		2	26	4		65	5		7	1	1	2			9	
42	Staf mbeshtetës-jo shëndetësorë		3	80			58			121	3	12	75			113			96		8	28
	Gjithsej	122	328	92	81	161	58	102	322	133	177	441	126	112	289	147	89	255	96	46	97	28

5.1. Performanca e Spitaleve të Përgjithshme



5.2. Shërbimet e kryera në Spitalet e Përgjithshme

Pjesë e planit të punës në kuadër të SHSKUK-së, janë edhe Spitale e Përgjithshme në qytete e Kosovës ku përfshijnë 1.986 shtretër.

Tabela 2. Sherbimet e Spitaleve të Përgjithshme

Shërbimet e realizuara në Spitalet e Përgjithshme									
Nr	Spitalet e Përgjithshme	Nr. i Shtretër.	Ditë shërimi	Të spitaliz.	Operac. kirurgj.	Vizita ambulan.	Shërbim. laborator.	Shërb.tjera diagnostike	Shfrytëz. e kapacit.
1	SP Vushtri	63	14394	4108	1782	46634	58613	23516	63%
2	SP Gjakovë	411	68777	14717	1894	67894	468119	13949	46%
3	SP Mitrovicë	171	34379	8481	2095	125141	170760	56639	55%
4	SP Ferizaj	89	17354	3727	1085	30633	121212	10152	53%
5	SP Gjilan	357	45016	10856	1253	140261	201370	73120	35%
6	SP Prizren	505	80308	19007	4597	124211	540479	129402	44%
7	SP Pejë	390	63554	12992	2368	180411	330986	65550	45%
	Totali	**1986**	**323782**	**73888**	**15074**	**715185**	**1891539**	**372328**	45%

Tabela nr. 1 tregon se në Spitale e Përgjithshme janë gjithsej 323.782 ditë shërimi apo 10% të shërbimeve në Spitalet e Përgjithshme për 73.888 pacientë të shtrirë në Spitalet e Përgjithshme. Nga këta pacientë, 15.074 pacientë janë operuar apo 20% e pacientëve të shtrirë në të gjitha spitalet të Kosovës. Gjithsej janë realizuar 715.185 vizita ambulantore apo 22% e shërbimeve, ndërsa 1.891.539 shërbime (parametra) laboratorike apo 57% (për 166.791 pacient) të total shërbime laboratorike. Numri i të operuar është 15074 pacientë. Shërbime tjera specifike dhe diagnostike ishin 372.328 apo 11% të gjithsej shërbimeve shëndetësore të



Figure 9 Përqindja e shërbimeve në Spitalet e Përgjithshme

ofruara në Spitalet e përgjithshme.

5.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve në Spitalet e Përgjithshme

Në përgjithësi Spitalet e Përgjithshme kanë ofruar gjithsejtt 3,276.549 shërbime. Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve (shtretërve) në shtatë Spitale të Përgjitshshme është 45%. Spitali i Pejës ka shfrytëzuyeshmërinë e kapaciteteve 45%, Spitali i Prizrenit ka shfrytëzueshmërinë 44%, Sipatli Gjilanit ka shfrytëzueshmëri të kapaciteteve me 35%, Spitali i Ferizajt ka shfrytëzueshmërinë me 53%, Spitali i Mitrovicës ka shfrytëzueshmëri të kapaciteteve me 55%. Spitali i Gjakovës ka shfrytëzueshmëri me 46% të kapaciteteve dhe Spitali i Vushtrisë me 63% të shfrytëzimit të kapaciteteve.



6. Shërbimet e kryera në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës

Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës përbëhet nga gjithsej 177 punëtorë. 20 nga punëtorët janë kuadër jo mjekësor, 78 janë të kuadrit infermierisë si dhe 79 punëtor janë mjekë specialistë. Në këtë institucion shëndetësor kryhen shërbime stomatologjike, të cilat do të pasqyrohen në tabelën në vijim.

QSKUK			
Vizita e pare/Vizite Kontrolluese	Aktivitete (sherbime) te Ofruara	Aktivitete jashte Prishtines	Paciente neper klinika
45073	141593	61526	8817



Figure 10 Përqindja e shërbimeve të ofruara në QKSUK

Në QKSUK gjatë viti 2021 janë kryer 45.073 vizita kontrolluese si vita e parë apo 18% nga numri i përgjithshëm i shërbimeve të ofruara. Janë kryer 141.593 shërbime stomatologjike apo të shprehuara në përqindje 55% të akvitete të ofruara nga numri përgjithshëm i shërbimeve. Po ashtu aktivitete jashtë Prishtinës janë kryer 61.526 aktivitete apo 24% nga shërbimet dhe janë kryer 8.817 shërbime për pacientë nëpër klinika apo të shprehura në përqindje 3%.

Klinika e Tirazhimit ka trajtuar 3001 pacientë. Klinika e Kirurgjisë Orale ka trajtuar 1.441 pacientë, klinika e Protetikës Stomatologjike ka kryer 464 pacientë, klinika e Ortopedisë së Nofullës ka kryer 1.082 pacientë, Klinika e Pedodoncisë dhe Stomatologjisë ka trajtuar 1.453 pacientë, Klinika e Paradontologjisë dhe Mjekësisë orale ka trajtuar 584 pacientë dhe Klinika e sëmundjeve të dhëmbit me endodoncion ka kryer 792 pacientë.

Figure 11 Numri dhe llojet e shërbimeve të ofruara në QKSUK

7. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës (QKMP) në Gjakovë

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, ofron shërbimeve shëndetësore nëpërmjet 13 Kabineteve Mjekësore. Edhe gjatë vitit

2021 ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve shëndetësore, duke funksionuar me kapacitete të plota profesionale dhe të aparaturave në shërbim të qytetarëve.

Shërbimet e realizuara në Qendrën Kombëtare të Mjeksisë së Punës Gjakove në vitin 2021				
Kabinete	Vizita Ambulatore	Vizita Diagnostike	Sherbime Larboatorike	Sherbime Tjera
13	17,153	31,262	91,796	1,781

Table 3 Numri I Shërbimeve të ofruara në Qendren Kombëtare të Mjekësisë së Punës-

Gjatë kësaj periudhe pune Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës ka ofruar 17,153 vizita ambulantore apo 12% nga totali i përgjithshëm të realizimit të shërbimeve të Mjekësisë se Punës, janë ofruar 31,262 vizita diagnostike apo 22%, po ashtu janë ofruar 91,796 shërbime laboratorike apo 65% për 6,885 pacientët që kanë kërkuar këto shërbime, dhe janë kryer 1,781 shërbime tjera apo 1% nga totali I shërbimeve të ofruara nga QKMP-Gjakovë.



Figure 12 Përqindja e shërbimeve të ofruara në QKMP

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë ka të punësuar gjithsejt 77 punëtor. Sipas struktures kualifikuese janë: punëtorë jo shëndetësorë janë 26 punëtorë apo 34%, infermerë janë 37 apo 48% dhe mjekë specialistë janë 14 apo 18% nga numri I përgjithshëm i punonjësve në këtë njësi. Ndërsa në bazë të strukturës gjinore në këtë qendër janë 50 punëtorë të gjinisë mashkullore apo 65% dhe 27 janë të gjinis femrore apo 35% nga numri i përgjithshë i të punësuarve.



Figure 13 Numri i punëtorëve sipas structures kualifikuese

8. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë

Ndonese kufizimet e imponuara nga masat e parandalimit të përhapjes së Covid-19, kanë imponuar edhe kufizime ne aktivitetet e QKTK gjatë vitit 2021 ka pas një ngritje të aktiviteteve te EVP ne distance dhe transmetimin virtual te tyre drejtpërdrejt në youtube dhe në faqen e QKTK në facebook, ku të gjitha ligjëratat dhe aktivitetet tjera edukative janë kryer me sukses.

Në vitin 2021 në Qendrën Kombëtare të Telemjeksisë së Kosovës ka pasur gjithsej 62 aktivitete me 6.897 vizita në biblotekën elektronike në total. Ku me së shumti ishin staf mjekësor me 3544 apo 51%, pastaj kemi 3350 ishin student apo 49% dhe 3 pjesëmarrës ishin të tjerë, jo profesionist shëndetësorë nga numri i përgjithshëm i vizitave.

Figure 14 Numri I shërbimeve të ofruara në QKTK

